



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI

Nr. 10/13 Prot.

Tiranë, më 09.01 .2018

VENDIM

Nr. 2 datë 09.01 2018

MBI

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE ME KOHË TË
PLOTË, NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË PËR
VITIN AKADEMIK 2018-2019**

Mbështetur në nenin 23,74,76 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-te e Republikës së Shqipërisë", në Rregulloren e UST-së neni 14 pika aa dhe në propozimet e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, në Vendimin e Rektoratit nr.1 dt. 08.01.2018, Senati I mbledhur me dt. 09.01.2017

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve me kohë të plotë në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë për vitin akademik 2018-2019.
2. Kriteret e pranimit të studentëve për Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes janë bashkangjitur këtij vendimi:
3. Kriteret e pranimit të studentëve për Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit janë bashkangjitur këtij vendimi:
4. Kriteret publikohen në portalin U-Albania brenda dt. 10.01.2018.
5. Një kopje e kriterëve i përcillet MASR dhe QSHA.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Rektori, Dekanet e Fakulteteve, Dega e Informacionit Studentor dhe Rregjistrimeve.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron Cuka



**KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE ME KOHË TË PLOTË, NË
PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË PËR VITIN
AKADEMIK 2018-2019 NË
FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT**

A. Kriteret e pranimit për Ciklin e I-rë të Studimeve Bachelor

Programi i studimit Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit”

1. Kanë të drejtë të pranohen në programin e studimit të Ciklit të I-rë Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave në fuqi.
2. Kandidatët i nënshtrohen konkurimit të Testimit Praktik konform testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallura në faqen web të UST.
3. Kandidatët që konkurojnë në këtë program studimi, duhet të plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore miratuar nga UST dhe e shpallur në faqen web të saj.
4. Kandidatët vlerësohen me pikë të grumbulluara, bazuar në rezultatet e konkursit në testimin praktik të UST-së dhe notës mesatare të shkollës së mesme. Sipas Vendimit Nr.7 datë 18.01.2016 të Senatit Akademik të UST, raporti ndërmjet konkurimit praktik dhe notës mesatares të kandidatit do të jetë në kufijtë 60% me 40%.
5. Klasifikimi i kandidatëve bëhet bazuar në sasinë e pikëve totale të grumbulluara, të vendosur në rendin zbritës. Fitojnë kandidatët me numrin më të madh të pikëve të grumbulluara.

B. Kriteret e pranimit për Ciklin e II-të të Studimeve Master Profesional

a) Programi i studimit Master Profesional në “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e Ciklit të II Master Profesional “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në Ciklin I-rë Bachelor pranë FVFR apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST, konform afateve dhe kriterëve të shpallura në faqen web të UST.
3. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i notës mesatare të ponderuar më të lartë. Klasifikimi i kandidatëve do të bëhet sipas notës mesatare të ponderuar në rendin zbritës. Fitojnë kandidatët me notën mesatare të ponderuar më të lartë.
4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar Ciklin e I-rë Bachelor në sistemin me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme të FVFR.
5. Në rastet kur rezultojnë vende të mbetura bosh, do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses Ciklin I-rë Bachelor në IAL të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare të ponderuar më të lartë.

b) Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e Ciklit të II Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në Ciklin I-rë Bachelor pranë FVFR apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Kanë të drejtë të konkurojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet në shkencat e menaxhimit dhe ato ekonomike në IAL-të respektive, duke shlyer numrin përkatës të krediteve të përcaktuar në programin e studimit.

3. Konkurrimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST, konform afateve dhe kritereve të shpallura në faqen web të UST.
4. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i notës mesatare të ponderuar më të lartë. Klasifikimi i kandidatëve do të bëhet sipas notës mesatare të ponderuar në rendin zbritës. Fitojnë kandidatët me notën mesatare të ponderuar më të lartë.
5. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar studimet pranë FVFR në Ciklin I-rë Bachelor (me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme).
6. Në rastet kur rezultojnë vende të mbetura bosh, do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses Ciklin I-rë Bachelor në IAL të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare të ponderuar më të lartë.

C. Kriteret e pranimit për Ciklin e II-të të Studimeve Master i Shkencave

Programi i Studimit Master i Shkencave “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e Ciklit të II Master i Shkencave “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”, të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në Ciklin I-rë Bachelor pranë FVFR apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurrimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST, konform afateve dhe kritereve të shpallura në faqen web të UST.
3. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i notës mesatare të ponderuar më të lartë. Klasifikimi i kandidatëve do të bëhet sipas notës mesatare të ponderuar në rendin zbritës. Fitojnë kandidatët me notën mesatare të ponderuar më të lartë.
4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar Ciklin e I-rë Bachelor në sistemin me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme të FVFR.
5. Në rastet kur rezultojnë vende të mbetura bosh, do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses Ciklin I-rë Bachelor në IAL të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare të ponderuar më të lartë.

6. Do të pranohen kandidatë që plotësojnë kriterin e njohjes së një prej 5 gjuhëve të huaja të BE: anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht, në nivelin B1 e lart. Pranohen dokumenta të njohjes së gjuhës së huaj të lëshuara nga subjektet e njohura prej MASR, që organizojnë testimet e gjuhës së huaj.

**KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE ME KOHË TË PLOTË, NË
PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË PËR VITIN
AKADEMIK 2018-2019 NË
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES**

A. Kriteret e pranimit për Ciklin e I-rë të Studimeve Bachelor

Programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes”

1. Do të pranohen në programin e studimit të Ciklit të I-rë Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave në fuqi.
2. Kandidatët i nënshtrohen konkurimit të Testimit Praktik konform testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallura në faqen web të UST.
3. Kandidatët që konkurojnë në këtë program studimi, duhet të plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore miratuar nga UST dhe e shpallur në faqen web të saj.
4. Kandidatët vlerësohen me pikë të grumbulluara bazuar në rezultatet e konkursit në testimin praktik të UST-së dhe notës mesatare të shkollës së mesme. Sipas Vendimit Nr.7 datë 18.01.2016 të Senatit Akademik të UST, raporti ndërmjet konkurimit praktik dhe notës mesatare të kandidatit do të jetë në kufijtë 60% me 40%.
5. Klasifikimi i kandidatëve bëhet bazuar në sasinë e pikëve totale të grumbulluara, të vendosur në rendin zbritës. Fitojnë kandidatët me numrin më të madh të pikëve të grumbulluara.

B. Kriteret e pranimit për Ciklin e II-të të Studimeve Master Profesional

Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e Ciklit të II Master Profesional “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në Ciklin I-rë Bachelor pranë FSHL apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST, konform afateve dhe kritereve të shpallura në faqen web të UST.
3. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i notës mesatare të ponderuar. Klasifikimi i kandidatëve do të bëhet sipas notës mesatare të ponderuar në rendin zbritës. Fitojnë kandidatët me notën mesatare të ponderuar më të lartë.
4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar Ciklin e I-rë Bachelor në sistemin me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme të FSHL.
5. Në rastet kur rezultojnë vende të mbetura bosh, do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses Ciklin I-rë Bachelor në IAL të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare të ponderuar më të lartë.

C. Kriteret e pranimit për Ciklin e II-të të Studimeve Master i Shkencave

Programi i Studimit Master i Shkencave “Shkenca Sportive”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e Ciklit të II Master i Shkencave “Shkenca Sportive”, të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në Ciklin I-rë Bachelor pranë FSHL apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST, konform afateve dhe kritereve të shpallura në faqen web të UST.

3. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i notës mesatare të ponderuar më të lartë. Klasifikimi i kandidatëve do të bëhet sipas notës mesatare të ponderuar në rendin zbritës. Fitojnë kandidatët me notën mesatare të ponderuar më të lartë.
4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar Ciklin e I-rë Bachelor në sistemin me kohë të plotë të FSHL.
5. Në rastet kur rezultojnë vende të mbetura bosh, do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses Ciklin I-rë Bachelor në IAL të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare të ponderuar më të lartë.
6. Do të pranohen kandidatë që plotësojnë kriterin e njohjes së një prej 5 gjuhëve të huaja të BE: anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht, në nivelin B1 e lart. Pranohen dokumenta të njohjes së gjuhës së huaj të lëshuara nga subjektet e njohura prej MASR, që organizojnë testimet e gjuhës së huaj.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. Agron Cuka

